

**THE OBJECTIVES AND FEASIBILITY OF LINGUISTICS IN THE MODERN ERA  
AND THE ROLE OF THE ALBANIAN LANGUAGE IN CONTEXT**

**Imer ALILI**

University of Tetova, Faculty of Philology, Italian Language and Literature  
imer.alili@unite.edu.mk

**UDC 811.18'1**

*Conference paper*

**Abstract**

My intervention consists in treating and developing, in the field of general linguistics, the contribution left by the late scholar Tullio De Mauro, who wrote the appendix “Alcuni caratteri tipici delle scienze linguistiche contemporanee” in a book translated into Italian with the title “Profilo storico della linguistica moderna” of the French author Maurice Leroy. In the appendix, Tullio De Mauro highlights some typical characteristics related to the differentiation of the systems and the linguistic productive modalities as such, for which it results that the languages are the depositaries of an infinite and determining power for other modern sciences, as well as a means of communication in different realities.

I would suggest that, perhaps, it would be useful and opportune that we Albanologists from these areas would consider it as part of and a branch of this vast and interrelated field of studies on an international level, whereby we should adjust and assimilate the experiences and the studies of the great international linguists, considering that these phases were already lived in western countries decades before us, but also on the basis of consideration that our society is undergoing changes in its social and society framework and attempts, in fact, to support other world realities. In the field of comparative linguistics, the Albanian language most definitely carries a very valuable treasure to support gnoseology in general, and thanks to this peculiarity, it can be inserted and integrated in many other scientific fields.

**Key words:** *Tullio De Mauro, albanology, linguistics.*

Për sa i përket faktit të gjuhësisë bashkëkohore, profesori dhe studiuesi, tanimë i ndjerë, Tullio De Mauro në shtojcën e tij: *Alcuni caratteri tipici delle scienze linguistiche contemporanee*, në librin e përkthyer *Profilo storico della linguistica moderna* të autorit francez Maurice Leroy, është munduar që të na e tundë këmbanën në vesh për faktin e «dallueshmërisë së sistemeve dhe modaliteteve prodhuese me fuqi të pafundme që kanë gjuhët si të tilla», por edhe si mjet komunikimi në realitete të ndryshme.

Prandaj, ndoshta, do të ishte e udhëzueshme që edhe ne në këto hapësirat tona, kur duam të punojmë diçka lidhur me Gjuhësinë si shkencë dhe albanologjinë si një lehë uji e kësaj fushe të gjerë studimesh, do duhej që t'i përshtatemi dhe t'i përqafojmë këso përvoja dhe këshillime gjuhëtarësh të mëdhenj, qoftë për faktin që këto faza, shtetet e zhvilluara perëndimore, i kanë përjetuar dikur më herët se ne e qoftë për shkakun se sot janë duke pësuar ndryshime edhe kornizat sociale dhe shoqërore në një nivel më të gjerë.

Sidoqoftë, është edhe e kuptueshme se çdo popull apo bashkësi i ka dhe i ushqen traditat e veta që e karakterizojnë si të tillë, prandaj edhe e trashëgon, por, edhe e përpunon atë traditë (gjuhësore) duke ia përshtatur rrethanave në të cilat vjen detyrimisht të ndodhet.

Në aspektin e rrafshit krahasimtar, gjuha shqipe sigurisht që ka një thesar shumë të pasur për t'i ndihmuar gnoseologjisë në përgjithësi, me çelësin e vet që mund të hapë më shumë dritare edhe të më shumë fushave.

Gjuhësia si shkencë, tanimë është zhvilluar në masë të kënaqëshme, duke prodhuar studime për të gjitha temat që me të kanë të bëjnë dhe me karakter epistomiologjik. Kështuqë, të gjitha ato iniciativa hulumtuese, sidoqoftë, mbeten një lëndë e parë në të cilat duhet mbështetur dhe vijuar edhe më tej të trajtohen dhe vlerësohen sepse shkencë është në një mënyrë edhe lineare dhe jo statike apo definitive, ashtu sikurse na dëshmohen akoma nga interpretimi i teksteve të fushës letrare, p.sh., të cilat herë pas here dhe varësisht nga rrethanat e reja, ribotohen, ripërpunohen apo interpretohen sipas gjykimit dhe shijes të secilit studiues apo autor.

Në këtë drejtim, nisma të shumëta ka pasur gjatë perkursit historik të njerëzimit, dhe atë qysh në kohët më të lashta. Mirëpo, më të shumta e më të theksuara na paraqiten sot, studimet e kohëve moderne, duke filluar nga shek. XVIII e këtej, ku kemi një shpërthim të këtyre studimeve; strukturalizmat evropian dhe ai amerikan, duke iu hapë shtegun një serë të tërë perspektivash e këndvështrimesh, në një shpërhapje kapilare dhe ku secila ka prodhuar rezultate dhe përfundime të vetat, të përshkruara e që na kontribuojnë në pasurimin dhe peshën e shkencës së Gjuhësisë.

Natyrisht, qëndrimet dhe tezat e studiuesëve të ndryshëm, jo çdoherë konvergjojnë dhe ndonjëherë edhe nuk janë të pranueshme nga të gjithë, por, pikërisht këtu pra, këto pikëpamje të dallueshme bëhen edhe nismëtare dhe shkaku i debateve të ndryshme ndërmjet hulumtuesëve të ndryshëm, që, pastaj, edhe nxjerrin në pah rezultatet e sajara dhe ndoshta, edhe të shpenzueshme për vet shkencën. Kjo është dialektika. Pikërisht, pra, sepse ndryshe nuk do të kishte arsye përse gjuhët të thirren bashkëkohore në vazhdimësi, sepse ato janë të gjalla, dinamike dhe si të tilla pësojnë ndryshime të vazhdueshme.

Prandaj, këto zhvillime apo ndryshime edhe lypin të trajtohen e të regjistrohen të shkruara nëpër dokumenta të ndryshëm. Për çka edhe kemi p.sh., “Fjalori më i ri i gjuhës X”, “Nuovo Devoto-Oli”, “New Dictionary of Standard English” etj. Është kështu, jo për shkaqe përfitimesh apo interesash, por, për faktin që secili botim i ri që paraqitet nëpër libraritë e ndryshme, përmban edhe fjalë të reja që bëhen pjesë e leksikut të një çfarëdo gjuhe, kështuqë përpiluesit e Fjalorëve apo Vokabularëve, e bëjnë vetëm punën e tyre duke i regjistruar dhe ilustruar ato ndryshime apo pasurime që i pëson një gjuhë.

Dhe, duhet të pranohet edhe fakti që, në kohët e sotme, ku, dinamiciteti i zhvillimeve ekonomike, teknologjike dhe shoqërore është përsheptuar aq shumë saqë na duhet të kemi kujdes, nëse ndonjë fakt gjuhësor është e mundur edhe të na ikë i pahetuar dhe i paregjistruar dhe si pasojë edhe i patrajtuar në aspektin e ngushtë gjuhësor si ai ortografik, ortoepik, morfologjik, sintaksor, ashtu si edhe ai i impaktit dhe rolit që këto huazime pastaj marrin në kontekstin e secilës gjuhë.

Nga aty, pastaj, edhe lind natyrshëm, ajo kureshtja për studimin dhe krahasimin e elementeve që ato i për afrojnë, ngjasojnë apo edhe që i dallojnë në mes tyre. Kjo fushë krahasimtare, sot, është bërë aq aktuale saqë të prodhojë edhe pikëpamje të panumërta ashtu si edhe studime nga të gjithë ekspertët dhe të interesuarit e këtij sektori. Këto studime sot janë kapilarizuar në atë masë saqë, të themi të vërtetën, ka mundësi edhe të na ikë i pahetuar ndonjë kontribut, pikërisht për numrin e madh të tyre.

Një kontribut të gjerë dhe të pamohueshëm për gjuhësinë historike dhe krahasimtare sot më e ka solidifikuar edhe dialektologjia, që ndoshta, si rrjedhë e natyrshme e ngjarjeve të kohës, duket të ketë zënë vendin dhe rolin e vet të merituar në fushën e Gjuhësisë. Kjo e fundit, për dallim nga fushat dhe drejtimet e zakonshme të studimeve të gjuhësisë, të cilat, ndoshta, kishin edhe ndonjë dozë shijeje politike, historike, pozitiviste apo supremacie, dialektet nuk kanë ndonjë qëllim ideologjik, ekonomik apo politik, por, ato vetëm duan të shprehin dhe ruajnë këtë të drejtë të tyre, edhe për faktin se masa më e tepërt e popullatës së një vendi mendon – dhe është mirë të jetë kështu –, që ashtu është më mirë të shprehen e që nuk duan të dinë përse

duheshka të jenë të detyruar të flasin ndonjë gjuhë të ‘imponuar’ dhe ‘artificiale’ siç do ta perceptonin ata. Për më tepër, ata janë edhe pronarët e vërtetë dhe të natyrshëm të një gjuhe të caktuar, pra ata janë *la langue* në atë kuptimin e Sausseur-it. Dhe, prapëseprapë, me gjithë ato sforcimet që i bëjnë gjuhëtarët, duke profetizuar që një popull duhet ta ketë të njëjtësuar gjuhën kombëtare për t’u bashkuar, sot më, në një botë dhe epokë të globalizimit, përpos faktit që të flitet për nacionalizma, pastërti gjuhe, kombi, race etj., bie ndesh me vet realitetin e krijuar në kohët e sotme, dhe atë në nivel global.

Pastaj, duhet shikuar mirë sot më, se çfarë domethënie kanë marrë dhe çfarë nënkuptohet me termat gjuhësor «komb» dhe «popull». Kështuqë, personalisht, jam i mendimit që ta lëmë rehat popullin shqiptar të stërlodhur më me përjetime përvojash gjithnjë dhe ndër shekuj me radhë, të dhimbëshme dhe të mos e rëndojmë me telashe tjera që nuk kanë të bëjnë me bukë, krypë e zemër. Popullata tanimë, e ka vërejtur dhe kuptuar se nuk hahet gjuha, as politika e jonë, por hahet bukë, mu ashtu si hahej dhe quhej bukë qysh në kohët e Herodotit, babait të historisë.

Është pikërisht kjo, arsyeja përse duket e vështirë dhe gati e pamundur tanimë, në këtë shekullin e XXI, që shqiptarëve të ju ‘imponohet’ një gjuhë e njëjtësuar, e kulluar, megjithë faktin dhe nevojën për ta unifikuar qoftë edhe në kuptimin si popull. Për më tepër, nuk kuptohet kjo nevojë kaq këmbëngulëse dhe kaq ‘urgjente’, pikërisht në këso çaste kur, në fakt, shohim zhvillime politike, kulturore shoqërore dhe ekonomike të cilat kundërthuhet me gjendjen reale.

Të len përshtypjen se ka shijen e një alibije, një arsyetimi për dështimin e derisotëm për realizimin e këtij projekti që populli ynë e ka merituar qysh prej shumë kohësh. Sido që të jetë, nga vet fakti që pronarë të vërtetë të gjuhës janë vet ata që e flasin, pra masa e popullit, që e përdorën atë si mjet komunikues dhe pavarësisht angazhimeve që i bëjmë ne si gjuhëtar dhe që e dijmë se është e nevojshme, ata vazhdojnë me atë perkursin e natyrshëm të të folurit, pa hezitime dhe atë qoftë për faktin që nevojitet një kohë mjaft e gjatë për asimilimin e kësajsoji faktesh demologjike dhe gjuhësore, siç kanë shkruar në këtë drejtim dhe ndër të tjerë edhe Meñendez Pidal.<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> R. Menéndez Pidal, *Origine del español*, Madrid, 1950, pp.532 e 533: «Los 300 años señalados por Saussure como caso notable de duración para la propagación de un cambio lingüístico, son todavía poca cosa en muchos casos». (Ata 300 vitet e sinjalizuara të Saussure-it si një kohë e gjatë dhe e vështueshme për përhapjen e një ndryshimi gjuhësor, janë megjithatë gjë e vogël në shumë raste.) Përkthimi ynë. Duhet poashtu të ceket se këtu ka të bëhet me studime të filologjisë romane, pra edhe për gjuhën spanjole. Këtu, kemi dashur ta marrim këtë si shembull, për të mund të konstatojmë për gjendjen faktike të gjuhës shqipe, konsolidimit dhe njëjtësimit të saj.

Prandaj, nuk vihet në diskutim nevoja e një njëjtësimi të gjuhës shqipe gjithandej ku janë shqiptarët, por, duhet të kihet mirë parasysh edhe sa u tha më sipër, një sërë faktorësh kulturor, historik, politik dhe ekonomik, për ta pa të realizueshme një nismë si kjo. Pastaj, gjurmimet dhe studimet duhen zhvilluar qoftë nga pikëpamja sinkronike e qoftë nga ajo diakronike dhe nuk duhet vazhduar më të ushqehet antinomia sinkronia-diakronia në kuptimin kundërthënës por, në atë të strukturalizmave amerikan dhe evropian të Bloomfield-it, Chomsky-t, etj., dhe të Martinet-it, Durkheim-it, Jakobson-it, Trubeckoj-t, Hjelmsev-it, etj., sepse ato në thelb janë edhe «dy ftyrat e të njëjtës medalje» (Maurice Leroy) dhe kontribuojnë në pasurimin e studimeve në fushën e Gjuhësisë, ashtu sikurse edhe të Albanologjisë.

Me njohjen dhe pasjen në konsideratë të gjitë asaj larmie materialesh, pastaj edhe do të jetë më e lehtë që të i nxjerrim edhe kontributet dhe konkluzionet tona eventuale si shqiptar, si pronar të natyrshëm të gjuhës shqipe dhe të gjitha atyre të folmeve, që pastaj na çojnë në rrafshin krahasimtar të vet gjuhës standarde shqipe dhe unifikimit të saj në nivel gjithëkombëtar. Mandej, sa ka të bëjë me rrafshin krahasimtar apo gjuhësinë historike, e cila ndryshe njihet edhe me termin diakronike, sot, më tepër se kurrë, është bërë e pranishme, si pasojë e digjitalizimit modern të botës dhe një kohe kur gjuhët, të gjithat, ashtu edhe shqipja, gëlltitin për ditë fjalë dhe shprehje të reja që, më tepër se ‘neologjizma’ siç janë quajtur deri më tani, do i quaja «globalizma» dhe janë shenjat e para të një faze «sinkretizmi» të një gjuhe të unifikuar dhe me dimensione shumë më të gjëra sesa edhe vet ne mund ta paramendojmë.

Për këtë, për sa të kenë jehonë gjuhët më të vogla, është edhe e këshillueshme që edhe gjuha shqipe ta japë gjithë atë kontributin e vet shumë të rëndësishëm për shkencën e Gjuhësisë dhe jo vetëm; ajo mundet që në masë të ndjeshme – dhe ndoshta, mund të jetë edhe e vetmja si gjuhë – të kontribuojë në masë të madhe edhe për *Mitologjinë* p.sh., po edhe për *Historinë*, *Filozofinë* etj. Është koha, tanimë, të fillohet të shtrihen studimet më kapilare që kanë të bëjnë me Gjuhësinë dhe që popujt tjerë, me studijuesit e tyre, kanë vëzhguar dhe thelluar këso studimesh në domenin e domethënies të sistemeve të gjuhëve.

Për këtë, ekzistojnë terminologjitë gjuhësore-shkencore si «psikosistematika»<sup>2</sup>, autor i cili shkruan edhe për një lloj «vështrimi të hollësishëm të konkretes me një reflektim abstrakt të thëllësishëm»<sup>3</sup> apo edhe «...për një të folur logjiko-gjeometrike (transkriptim i operacioneve të mendimit në skema figurative) për t’i shfaqur hollësitë e «psikomekanikës»<sup>4</sup>.

---

<sup>2</sup> Le të shihet për këtë, G. Guillaume, *La langue est-elle ou n'est-elle pas un système?*, Quebec, 1952, fq.4.

<sup>3</sup> G. Guillaume, *L'architectonique du temps dans les langues classiques*, Copenhagen, 1945.

<sup>4</sup> Roch Valin, *Petite introduction à la psychomécanique du langage*, Quebec 1954.

Ti shohësh datat e botimit të këtij soji të punimeve si më poshtë (në fusnota), flet vet se sa nevojë kemi ne që, së paku, ti nisim dhe zhvillojmë kësisoji studimesh të cilat në vendet perëndimore kanë bërë traditë të solidifikuar por edhe të përparuar. Pastaj, vijimisht, këto studime kanë të bëjnë dhe ndërliken edhe me një disiplinë tjetër të gjuhësisë e cila quhet *Filozofia e të folurit* dhe jo Filozofia e gjuhës!, dhe, vetëm kështu zgjerohet rrezatimi i gnoseologjisë, për çka kemi shumë nevojë në këto kohëra moderne dhe ndryshimesh epokale në nivelin global.

Në prodhimtarinë letrare të shqipes ne, sot më, kemi të prodhuar aq bibliografi saqë do ishte e udhës që të hapet një fushë e vërtetë dhe e drejtuar në lëminë e Filologjisë, duke bërë punime të mirëfillta me studime dhe «botime kritike» edhe me «aparartet kritike» përkatës, të monografive por edhe të dorëshkrimeve të shumta të autorëve të ndryshëm shqiptar, të të gjitha hapsirave ku ata jetojnë, të cilët, në do kohë, pos tjerash edhe jo shumë të largëta, iu është dashur të shkruajnë në gjuhën shqipe por me alfabetë të huaja. Do të ishte padyshim një pasurim i shkencës shqiptare në përgjithësi.